

VENDIM
Nr.39, datë 25.5.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR EKSPORT-IMPORTET E KARTËMONEDHAVE E TË MONEDHAVE METALIKE
SHQIPTARE”

(ndryshuar me vendimet e Bankës së Shqipërisë: nr. 50, datë 31.7.2013 dhe nr. 66, datë 1.12.2021)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 34 dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për eksport-importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.83, datë 7.11.2001 “Për miratimin e rregullores “Për eksport-importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR EKSPORT-IMPORTET E KARTËMONEDHAVE DHE TË MONEDHAVE METALIKE
SHQIPTARE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sasisë dhe i procedurave për eksport-importin e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

(ndryshuar shkronja “g” me vendimin nr. 66, datë 1.12.2021)

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Monedhë” janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare me ose pa kurs ligjor.

b) "Monedhë me "kurs ligjor"" janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat nuk janë tërhequr nga qarkullimi dhe që shërbejnë si mjet pagese e pranohen për të gjitha pagesat e detyrimeve që individët ose subjektet e ndryshme, private ose publike, kryejnë me njëri-tjetrin.

c) "Monedhë pa "kurs ligjor"" janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare, të cilat janë tërhequr nga qarkullimi dhe që nuk mund të shërbejnë si mjet pagese për pagesat e detyrimeve që individët ose subjektet e ndryshme, private ose publike, kryejnë me njëri-tjetrin.

d) "Cash" është gjendja fizike e monedhave, që eksportohen dhe importohen fizikisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

e) "Eksport" është nxjerrja në *cash*, nga territori i Republikës së Shqipërisë, e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

f) "Import" është futja në *cash*, në territorin e Republikës së Shqipërisë, e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

g) "Person" është *individi, personat fizikë tregtarë dhe personat juridikë*, sipas kuptimit që i jep neni 26 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

h) "Individ" kupton çdo shtetas, shqiptar ose të huaj, rezident ose jorezident në Republikën e Shqipërisë.

i) "Veprimtari numizmatike" është mbajtja e kartëmonedhave ose monedhave metalike me ose pa kurs ligjor, për qëllime koleksionimi dhe/ose studimi.

KREU II IMPORTI DHE EKSPORTI I MONEDHAVE

Neni 4 E drejta ekskluzive

Importi *cash* i monedhave shqiptare me kurs ligjor, është e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë.

Neni 5 Import-eksporti

(ndryshuar me vendimin nr. 66, datë 1.12.2021)

1. Çdo person, ka të drejtë të eksportojë ose të importojë në *cash* monedha shqiptare me ose pa kurs ligjor nga/në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Në çdo rast, personat zbatojnë detyrimet për deklarimet pranë autoriteteve doganore në kufi, sipas përcaktimeve në legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.

Neni 6 Eksporti nga Banka e Shqipërisë për përshtatjen e makinave të përpunimit të monedhës

(ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 50, datë 31.7.2013 dhe ndryshuar me vendimin nr. 66, datë 1.12.2021)

1. Banka e Shqipërisë, për përshtatjen e makinave të veta të përpunimit të monedhës, kryen eksport të monedhave shqiptare.

2. Eksporti, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me urdhër me shkrim të administratorit përkatës.

3. Urdhri, sipas pikës 2 të këtij neni, bazohet në relacionin e përgatitur nga Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë. Në çdo rast, urdhri përmban, gjithashtu, edhe sasinë e monedhave që do të eksportohet.

Neni 7

(shfuqizuar me vendimin nr. 66, datë 1.12.2021)

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 8
Shfuqizime

Rregullorja “Për eksport – importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare”, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.83, datë 7.11.2001, shfuqizohet.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.